



INFORMACIONE PËR ZGJEDHJET RAJONALE DHE KOMUNALE TË VITIT 2025

Zgjedhjet rajonale dhe komunale në Finlandë mbahen **të dielën, më 13.4.2025**. Këshillat komunale dhe rajonale të mirëqenies zgjidhen në çdo katër vjet me zgjedhjet komunale dhe rajonale.

Finlanda është e ndarë në komuna që kanë pushtet vetëqeverisës sipas Kushtetutës (731/1999). Komuna është përgjegjëse për realizimin e pjesës më të madhe të shërbimeve bazë për banorët e saj. Pushteti më i lartë vendimmarrës i komunës ushtrohet nga këshilli komunal i zgjedhur me votime.

Kushtetuta gjithashtu parashikon që vetëqeverisja në zonat administrative më të mëdha se komunat të rregullohet me ligj. Në vitin 2021, në Finlandë u krijuan 21 rajone të mirëqenies vetëqeverisëse, në të cilat u transferua përgjegjësia nga komunat për organizimin e shërbimeve të kujdesit social dhe shëndetësor si dhe të shërbimit të shpëtimit. Në rajonin e mirëqenies, pushteti më i lartë vendimmarrës ushtrohet nga këshilli rajonal i zgjedhur me votime.

Zgjedhjet rajonale dhe komunale nuk mbahen në krahinën e Ahvenanmaa. Banorët e qytetit të Helsinkit kanë të drejtë të votojnë vetëm në zgjedhjet komunale, sepse Helsinki nuk i përket asnjë rajoni të mirëqenies.

E drejta e votës - kush mund të votojë?

Kushti për të drejtën e votës në zgjedhjet rajonale dhe komunale është që të keni mbushur 18 vjeç më së voni në ditën e zgjedhjeve (13.4.2025).

Përveç kësaj, duhet të keni edhe vendbanimin tuaj komunal në Finlandë si më poshtë:

- Shtetasit e Finlandës ose të një shteti tjetër që i përket Bashkimit Evropian, të Islandës ose Norvegjisë duhet të kenë vendbanimin e regjistruar në Finlandë jo më vonë se data 21.2.2025
- Shtetasit e vendeve të tjera duhet të kenë të regjistruar vendbanimin e tyre në Finlandë në kohë të vazhdueshme për të paktën dy vjet deri më datën 21.2.2025.

Komuna e vendbanimit tuaj përcaktohet në bazë të ligjit të vendbanimit komunal (210/1994). Vendbanimi komunal është në përgjithësi komuna ku jeton.

Në zgjedhjet komunale të vitit 2025, keni të drejtën e votimit në komunën që në sistemin informativ për popullsinë më 21.2.2025 në ora 24 është e shënuar si komuna e vendbanimit tuaj.

Nëse nevojitet, informatën për komunën e vendbanimit tuaj kontrolloje në Agjencinë e informacioneve dixhitale dhe të popullsisë (Digi- ja väestötietovirasto).

Në zgjedhjet komunale mund të votoni vetëm për kandidatin e komunës suaj. Në zgjedhjet rajonale, mund të votoni vetëm për kandidatin e rajonit tuaj të mirëqenies.

Në Finlandë votimi në zgjedhje është vullnetar.

Njoftimi për të drejtën e votës i dërgohet gjithë atyre që kanë të drejtë vote

Agjencia e informacioneve dixhitale dhe e popullsisë në kohë të votimeve krijon një regjistër ku do të përfshihen të gjithë personat që kanë të drejtë vote. Nuk ka nevojë të regjistroheni veçmas në regjistrin për të drejtën e votës.

Agjencia e informacioneve dixhitale dhe e popullsisë do të dërgojë njoftimin për të drejtën e votës atyre që kanë të drejtë vote, më së voni deri **më 20.3.2025**. Do të njoftoheni për të drejtën tuaj për të votuar në mënyrë elektronike vetëm nëse keni aktivizuar shërbimin e mesazheve Suomi.fi (më shumë informacione në www.suomi.fi/veistit).

Njoftimi për të drejtën e votës përmban udhëzime se si do të votoni, listën e vendeve të votimit të parakohshëm në rajonin ku jetoni dhe informacione për të drejtën tuaj të votës. Nuk keni nevojë të merrni me vete në qendrën e votimit njoftimin për të drejtën e votës, mjafton një kartelë identiteti. Megjithatë, duhet të sillni me vete njoftimin për të drejtën e votës nëse votoni në një institucion ose jashtë vendit.

Përshtatshmëria për tu zgjedhur - kush mund të jetë kandidat?

Mund të jeni kandidat *në zgjedhjet komunale*, nëse

- ke vendbanimin komunal në komunën në të cilën je emëruar si kandidat; dhe
- ke të drejtë vote në zgjedhjet komunale në ndonjë nga komunat e Finlandës.

Mund të jeni kandidat *në zgjedhjet rajonale*, nëse

- ke vendbanim komunal në rajonin e zonës së mirëqenies ku je emëruar si kandidat; dhe
- ke të drejtë vote në zgjedhjet rajonale në ndonjë zonë të mirëqenies.

Megjithatë, një numër i zyrtarëve qeveritarë sipas ligjit për zonat e mirëqenies dhe ligjit të komunave, si dhe disa punonjës dhe zyrtarë udhëheqës të zonës së mirëqenies ose komunës, nuk kanë të drejtë të jenë kandidatë për zgjedhje.

Nuk mund të jenë kandidatë në zgjedhje edhe ata që janë shpallur fajtor me vendimin e gjykatës.

Emërimi i kandidatëve

Kandidatët në zgjedhjet rajonale dhe komunale mund të emërohen nga

- partitë e regjistruara
- votuesit me të drejtë vote që kanë krijuar shoqatën e tyre si votues.

Kandidatët për zgjedhjet rajonale dhe kandidatët për zgjedhjet komunale emërohen veçmas.

Partitë vendosin për kandidatët e tyre sipas rregullave të tyre. Nëse dëshironi të jeni kandidat i një partie, duhet bërë marrëveshje me partinë në fjalë.

Për themelimin e shoqatës së votuesve, në zgjedhjet komunale nevojiten dhjetë banorë të komunës që kanë të drejtë vote. Megjithatë, në komunat me një popullsi të vogël, mjaftojnë vetëm tre ose pesë banorë për të krijuar një shoqatë zgjedhësish.

Në zgjedhjet rajonale nevojiten 50 banorë të së njëjtës zonë të mirëqenies që kanë të drejtë vote për të krijuar një shoqatë të votuesve.

Kërkesat për kandidimin tuaj si kandidat dorëzohen për zgjedhjet rajonale në këshillin rajonal zgjedhor të secilës zonë të mirëqenies dhe për zgjedhjet komunale në këshillin qendror zgjedhor të secilës komunë.

Çdo kandidat i pranuar zyrtarisht ka numrin e tij të kandidatit. Nëse i njëjti person është kandidat si në zgjedhjet rajonale ashtu edhe në ato komunale, ai ka numër tjetër si kandidat në zgjedhjet rajonale dhe numër tjetër si kandidat në zgjedhjet komunale. Listat e kombinuara me emrat e kandidatëve të shtypura në letër përgatitet për të dy zgjedhjet, ku emrat e kandidatëve janë shënuar sipas numrit të tyre.

Listat e kombinuara të kandidatëve do të përpilohen më 13.3.2025. Ato mund të shihen, për shembull, në qendrat e votimit dhe në faqet e zgjedhjeve të Ministrisë së Drejtësisë (www.vaalit.fi).

Votimi

Mund të votoni ose në ditën e zgjedhjeve, të dielën 13.4.2025, ose para ditës së zgjedhjeve gjatë votimit të parakohshëm.

Mund të votoni në të gjitha qendrat e votimit njëkohësisht për zgjedhjet rajonale ashtu edhe për ato komunale. Nëse dëshironi, mund të votoni vetëm për njërin nga zgjedhjet.

Mund të votoni vetëm një herë për çdo zgjedhje.

Votimi në zgjedhjet rajonale bëhet me fletë ngjyrë vjollcë dhe në zgjedhjet komunale me fletë të bardhë.

Votimi i parakohshëm:

Votimi i parakohshëm fillon të **merkurën 2.4.2025**.

Votimi i parakohshëm jashtë vendit përfundon të **shtunën 5.4.2025** dhe në Finlandë të **martën 8.4.2025**.

Vendet e votimit të parakohshëm mund të jenë të hapura në kohë të ndryshme gjatë këtyre ditëve.

Mund të votoni parakohe në çdo vend të përgjithshëm të votimit të parakohshëm në Finlandë ose jashtë saj.

Mund të gjeni informacione rreth vendeve të përgjithshme të votimit të parakohshëm, sikurse vendndodhjet dhe kohën e hapjes, p.sh. në shtojcën e njoftimit për të drejtën e votës dhe nga faqet www.vaalit.fi.

Përveç vendeve të përgjithshme të votimit të parakohshëm, votimi i parakohshëm në masë të kufizuar mund të mbahet edhe në ambiente të tilla si spitale, njësitë e mirëqenies sociale, garnizone ushtarake dhe në institucione të ndëshkimit penal, ose në anijet finlandeze jashtë vendit. Në institucione mund të votojnë vetëm personat që trajtohen në to ose të pranuar në to, në anije vetëm personeli i anijes.

Votuesi që ka vështësi të dukshme për të shkuar në qendrën e votimit mund të votojë me votim të parakohshëm edhe nga shtëpia. Për të votuar nga shtëpia, duhet me qenë i regjistruar në këshillin qendror zgjedhor të komunës suaj jo më vonë se data 1.4.2025 para orës 16.

Nëse je jashtë vendit gjatë gjithë kohës së votimit edhe në ditën e zgjedhjeve, mund të votoni edhe nga jashtë shtetit me letër postare.

Për të votuar me postë, duhet për të porositur materialin e votimit me postë në adresën tuaj jashtë vendit nga shërbimi për dërgesa i Ministrisë së Drejtësisë (www.vaalit.fi/kirjeaanestys).

Votimi në ditën e zgjedhjeve:

Votimi në ditën e zgjedhjeve është të **dielën më 13.4.2025 nga ora 9–20**.

Në ditën e zgjedhjeve, mund të votohet vetëm në qendrën e votimit në komunën tuaj që është e shënuar në njoftimin që është dërguar për të drejtën e votimit.

Udhëzime më të detajuara sesi të votohet mund të merren, p.sh. nga njoftimi për të drejtën tuaj për të votuar, nga www.vaalit.fi ose nga zyrtarët zgjedhorë në qendrën e votimit.

Të dhëna shtesë

- Më shumë informacione rreth zgjedhjeve merren nga këshilli qendror zgjedhor i komunës suaj. Pyetjeve për të drejtën personale të votës i përgjigjet Agjencia për informacione dixhitale dhe popullsi. Të dhënat kontaktuese për të dy palët janë në njoftimin për të drejtën e votimit.
- Adresat dhe koha e hapjes së vendeve të votimit të parakohshëm, udhëzimet për porositjen e votimit me postë, informacionet për kandidatët dhe informacione të tjera rreth zgjedhjeve mund të lexohen nga faqet e zgjedhjeve në internet të Ministrisë së Drejtësisë në adresën **www.vaalit.fi**.